



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d, dhe nenit 40, paragrafi 40.2, pika c të Ligjit nr. 03/ L – 040, për vetëqeverisje lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 28/15 qershor 2008), nenin 30.2 të Ligjit nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe të dispozitave të nenit 34, paragrafi 34.1, pika d e Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 – 391, të dt. 25.2.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 27.05.2016, merr këtë

V E N D I M

PËR TRANSFERIMIN E MJETEVE PËR PROJEKTIN E EFIQIENCËS SË ENERGJISË ME KFW

Neni 1

MIRATOHET Vendimi për transferimin e mjeteve për projektin e efijencës së energjisë me KFW.

Neni 2

Mjetet sipas nenit 1 të këtij vendimi transferohen nga fondi i buxhetit të rregullt të projekteve të investimeve kapitale në fondin 04-financimet nga huamarrjet për vitin 2016.

Neni 3

Shuma e mjeteve të transferuara, në baze të nenit I të këtij vendimi, është 50,000.00 €.

Neni 4

Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen Kryetari i Komunës dhe Drejtorja e Financave.

Neni 5

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në web-faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01. Nr. 040 – 133719, më 01.06.2016

